



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 157/11 Prot.

Tiranë, më 28/4/2016

REKOMANDIM

Nr. 9, datë 28/4/2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, si dhe neneve 80-104 të Ligjit nr. 8485, datë 12/05/1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "Shërbimi Përmbartimor ZIG" sh.p.k, Tiranë,

VËREJ SE :

Në zbatim të kërkesave të Urdhrit nr. 48, datë 01.03.2016 dhe Urdhrit nr. 48/1, datë 17.03.2016, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit "Shërbimi Përmbartimor ZIG" Sh.p.k, me objekt:

- Verifikimi i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga ana e personave me iniciale dhe , nr. 157/1 prot, datë 29.02.2016, në kuadër të respektimit të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale.
- Plotësimi i detyrimit për njoftim, (Nenet 21, 22) të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar;
- Verifikimi i ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave, gjatë procesit të regjistrimit dhe verifikimit të subjekteve të të dhënave, në hyrje-dalje të ndërtesës në të cilën ushtron aktivitetin Kontrolluesi, në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

Kontrolluesi "Shërbimi Përmbartimor ZIG" Sh.p.k, është person juridik jopublik, që operon në fushën e veprimtarisë, ekzekutimin e detyrueshëm lidhur me, *vendimet civile të gjykatës që kanë marrë formë të prerë, që përmbajnë një detyrim, vendimet e dhëna prej tyre për sigurimin e padisë, si dhe për ekzekutimin e përkohshëm., etj.*

1- Hetimi administrativ pranë këtij kontrolluesi është iniciuar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga ana e personave me iniciale F. A dhe H. A, të cilët referonin faktin se janë kontaktuar nëpërmjet telefonit nga një punonjës i Shërbimit Përmbartimor ZIG Sh.p.k, me qëllim për t'i dorëzuar një zarf (Lajmërim për ekzekutimin vullnetar të detyrimit) që nuk i drejtohej dhe nuk i përkiste ankuesit apo pjesëtarëve të tjerë të familjes së tij. Ankuesi pretendonte se nuk kishte dhënë në asnjë moment pëlqimin apo autorizimin për përpunimin e të dhënave personale të tij, nga "Shërbimi Përmbartimor ZIG" Sh.p.k dhe se ka të paqartë arsyen e mbledhjes, burimin dhe mënyrën e paautorizuar të trajtimit të këtyre të dhënave personale nga ky subjekt.

Zyra e Komisionerit pas kryerjes së veprimeve hetimore administrative, në kuadër të zbatimit të legjislacionit në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, vlerëson se pretendimet e palës ankuese nuk janë të bazuara në prova dhe fakte. Në veprimet e kryera nga kontrolluesi në kuadër të respektimit të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale, në zbatim të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, nuk u konstatuan shkelje në përpunimin e të dhënave në lidhje me rastin konkret.

2- Në kuadër të zbatimit të detyrimit për njoftim, Nenet 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, grupi i hetimit paraprakisht konstatoi se kontrolluesi “Shërbimi Përmbarrimor ZIG” Sh.p.k, e kishte realizuar detyrimin për njoftim. Megjithatë, nga analizimi i përmbajtjes së njoftimit dhe verifikimet e kryera pranë kontrolluesit, rezultoi se nuk ishte kryer përditësimi për ndryshim të gjëndjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave, sa i përket deklarimit, si më poshtë:

- “Të dhënat e subjektit kontrollues”, kontrolluesi nuk kishte përditësuar deklarimin për adresën e tij.
- “Kategoritë e subjekteve të të dhënave personale që përpunohen”, kontrolluesi përpunonte të dhënat personale, të çdo vizitori ose personi tjetër në hyrje të qendrës të cilët nuk janë palë në një procedurë ekzekutimi, si dhe të dhëna për kategorinë e subjekteve punëmarrës.
- “Kategoritë e të dhënave personale që përpunohen”, kontrolluesi përpunonte më shumë të dhëna personale nga sa ka deklaruar. Përpunohen të dhënat personale, nr i telefonit, adresë e-maili, nr. personal i identifikimit, nënshkrimi.

Në nenin 25/1 të ligjit të sipërcituar, parashikohet se kontrolluesi nuk mund të fillojë përpunimin e të dhënave personale pa njoftuar më parë zyrën e Komisionerit. Kontrolluesi nuk duhej të vazhdonte përpunimin e të dhënave personale pa njoftuar Zyrën e Komisionerit për ndryshim të gjëndjes së njoftimit të përpunimit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se detyrimi për njoftim dhe përditësimi i “Formularit të Njoftimit”, është i rëndësishëm pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i jep ligji.

3- Në kuadër të verifikimit të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale, gjatë procesit të regjistrimit dhe verifikimit të subjekteve të të dhënave, në hyrje-dalje të ndërtesës në të cilën ushtron aktivitetin Kontrolluesi “Shërbimi Përmbarrimor ZIG” Sh.p.k, grupi i hetimit administrativ konstatoi se ato mblidheshin dhe përpunoheshin nëpërmjet regjistrit që mbahet manualisht dhe një sistemi vëzhgimi me kamera CCTV nga ana e punonjësit të SH.P.S.F “OKTAPUS” Sh.p.k (në cilësinë e përpunuesit) për llogari dhe interes të kontrolluesit. Marrëdhënia midis tyre sanksionohet nëpërmjet një kontrate “Për marrjen në ruajtje dhe sigurim të objektit”.

Nga analizimi i kontratës rezultoi se, nuk janë parashikuar plotësisht detyrimet përkatëse të palëve lidhur me mënyrën e përpunimit, garantimin e sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave personale, të drejtat e subjekteve të të dhënave, etj, sipas përcaktimeve në nenin 20 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

Të dhënat që mblidheshin nga SH.P.S.F “OKTAPUS” Sh.p.k nëpërmjet regjistrit ishin *emri, mbiemri, numri i kartës së identitetit dhe nënshkrimi* i personave që hyjnë në ndërtesë. Gjithashtu për qëllime të garantimit të sigurisë në godinë, në hyrje-dalje dhe në ambientet e brendshme të zyrave të “ZIG Sh.p.k” ishte instaluar edhe një sistem kamerash CCTV, që aksesohet nga SH.P.S.F “OKTAPUS Sh.p.k”.

Gjithashtu, grupi i hetimit administrativ konstatoi se kontrolluesi kishte hartuar “Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”. Nga analizimi i saj rezultoi se nuk janë parashikuar rregulla specifike mbi sigurinë e të dhënave të përpunuara nëpërmjet regjistrit në hyrje-dalje të godinës, nuk janë përcaktuar afate mbi mbajtjen e të dhënave dhe rregulla mbi procedurat e shkatërrimit të të dhënave, në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

Në lidhje me sistemin CCTV, kontrolluesi deklaroi se sistemi i kamerave ishte vendosur në ambientet e godinës dhe administrohej prej pronarit të saj me qëllim vetëm view-er dhe se e kishte të pamundur për të krijuar akses në pajisjen apo programin e menaxhimit të kamerave. Zyra e Komisionerit vlerëson se aksesin në këto sisteme dhe pajisjet e tyre është i mbrojtur me fjalëkalim (që është dhe masë sigurie që kërkohet ligjërisht) dhe është përgjegjësia e personit përgjegjës që merret me administrimin e sistemit CCTV për t’i siguruar grupit të hetimit administrativ aksesin në sistemin e përpunimit të të dhënave ku është instaluar sistemi.

Megjithatë, rezulton se nga asnjëra palë nuk janë marrë masa në lidhje me të drejtën për informim, pasi subjektet e të dhënave (personat që japin të dhëna në hyrje-dalje të godinës dhe që xhirohen nëpërmjet sistemit CCTV), nuk janë informuar mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që i përpunon të dhënat, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave dhe masat e sigurisë, në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

Për shkeljet e konstatuara është mbajtur procesverbali i konstatimit në momentin e ushtrimit të hetimit administrativ (që mban datën 24.03.2016). Në përmbajtje të procesverbalit, përfaqësuesi i kontrolluesit, deklaroi se: “*Pretendimet tona do ti paraqesim me shkrim brenda datës 29.03.2016*”. Një kopje e procesverbalit iu dorëzua kontrolluesit.

Në vijim, kontrolluesi ka depozituar pretendimet nëpërmjet shkresës administruar me nr. 157/7 prot, datë 29.03.2016 mbi “*Proces Verbalin e Hetimit Administrativ datë 24.03.2016, të grupit të inspektimit*”, administruar në dosjen hetimore në cilësinë e provës.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar si dhe në zbatim të neneve 93-96 të ligjit nr. 8485, datë 12/05/1999 “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, me shkresën nr. 157/4 prot. dt. 29/03/2016 është njoftuar kontrolluesi “*Shërbimi Përmbartimor ZIG*” Sh.p.k për pjesëmarrje në procesin e shqyrtimit administrativ, pranë ambienteve të Zyrës së Komisionerit, më datë 15/04/2016 ora 11:00, në lidhje me pretendimet e mundshme.

Në seancën dëgjimore, përfaqësuesi i kontrolluesit ka deklaruar se:

- Është realizuar përditësimi i formularit të njoftimit, duke deklaruar adresën e re;
- Kamerat që ndodhen në ambientin e Shoqërisë Përmbartimore Zig, nuk janë tonat, por kanë qenë të instaluarat paraprakisht nga ana e pronarit të objektit, pra të qiradhënësit. Qëllimi i vetëm i kamerave është për të ndihmuar punonjësin e SH.P.S.F “OKTAPUS” Sh.p.k në kryerjen e detyrave të tij;

Në lidhje me pretendimin mbi sistemin e kamerave të vëzhgim regjistrimit CCTV, grupi i hetimit konstatoi se kamerat ishin të vendosura edhe brenda zyrave të kontrolluesit, duke mbledhur dhe përpunuar të dhëna si për subjektet e të dhënave “Palët në një procedurë ekzekutimi” po ashtu dhe për punëmarrësit e tij. Në zbatim të nenit 27 të ligjit dhe të Udhëzimit Nr. 11 të Komisionerit datë 08.09.2011 “Mbi përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat”, është përgjegjësi e kontrolluesit për të marrë masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale (të siguruara nëpërmjet mjeteve të cilat ndodhen në ambientet ku ushtron aktivitetin), nga shkatërrime të paligjshme, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi.

- Përsa i përket konstatimit se nuk është deklaruar për kategorinë punëmarrës, Shoqëria Përmbarimore Zig, nuk administron dosje personale të punonjësit përveç faktit që secili prej tyre është i deklaruar në Zyrën e Punës dhe në Drejtorinë Rajonale Tatimore, si dhe rregullisht paguhen kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;

Në lidhje me pretendimin mbi kategorinë e subjekteve punëmarrës, nga grupi i kontrollit rezulton që kontrolluesi, nuk respekton legjislacionin në lidhje me të dhënat personale të punonjësve dhe gjithashtu, në seancë dëgjimore kontrolluesi në mënyrë kontradiktore deklaroi që të gjithë punonjësit janë përmbarues dhe janë të regjistruar në organet përkatëse pranë Ministrisë së Drejtësisë. Për deklaratimet e punonjësve në zyrat përkatëse nuk u paraqit asnjë provë gjatë hetimit administrativ të ushtruar.

- Në lidhje me regjistrimin/mbajtjen e regjistrimit hyrje – dalje, ky regjistrim plotësohej nga ana e punonjësit të “OKTAPUS” dhe në asnjë moment nuk i është kërkuar që të mbahen apo të përpunohen e të ruhen të dhënat e çdo vizitori në hyrje të qendrës. Megjithatë, me sugjerimin e inspektorëve, ne ndryshuam formatin, aplikojmë një format “Kërkesë për takim informues” për trajtim ndaj çdo pale të regjistruar në zbatim të urdhrave përkatës të ekzekutimit.

Në vijim janë paraqitur në cilësinë e provës “Formulari i njoftimit” i ndryshuar, nëpërmjet të cilit është njoftuar vetëm ndryshimi i adresës së kontrolluesit, Kontrata e qirasë, ndërmjet pronarit të godinës dhe Shërbimit Përmbarimor ZIG, një format të kërkesës për takim informues, deklaratën e qiradhënësit të godinës ku deklaroi se të gjitha kamerat që janë pranë objektit të dhënë me qira, janë të vendosura dhe administrohen prej tij.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 29, 30, 31 pika 1/ ”a/1” dhe 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të Kodit të Procedurës Administrative:

#### **REKOMANDOJ:**

1. Kontrolluesi, të marrë masa për nënshkrimin e një kontrate me administratorin (pronar i godinës që ka instaluar sistemin) e sistemit të vëzhgim regjistrimit me kamera CCTV, të instaluar në ambientet e zyrave të tij, ku të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve dhe subjekteve të të dhënave personale.
2. Në zbatim të nenit 18 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të tregohet kujdes që të informohen subjektet e të dhënave, të cilët japin të dhëna në hyrje-dalje të godinës, mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të

dhënave personale, personin që i përpunon të dhënat, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave;

3. Në zbatim të neneve 21 dhe 22 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, të përditësohet njoftimi sipas ndryshimeve të gjendjes së njoftimit të përpunimit pranë Zyrës së Komisionerit dhe të tregohet kujdes në vijimësi në përditësimin e tij;
4. Në zbatim të nenit 20 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, në kontratën e shërbimit me përpunuesin SH.P.S.F "OKTAPUS" Sh.p.k, të parashikohen masat konkrete lidhur me, garantimin e sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave personale, të drejtat e subjekteve të të dhënave, etj;
5. Në zbatim të nenit 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, të parashikohen në "*Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*" masat konkrete organizative dhe teknike për të mbrojtur të dhënat personale, rregulla specifike mbi sigurinë e të dhënave të përpunuara nëpërmjet regjistrit në hyrje-dalje të godinës, afate mbi mbajtjen e të dhënave dhe rregulla mbi procedurat e shkatërrimit të të dhënave;
6. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara në pikën 1 dhe 2 të këtij Rekomandimi, brenda një afati 30 ditor nga momenti i marrjes dijeni. Pas këtij afati të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mbi masat e marra në zbatim të Rekomandimit të mbështetura nga aktet përkatëse.
7. Plotësimi i këtyre detyrimeve ligjore mund të jetë objekt kontrolli në vazhdimësi nga Zyra e Komisionerit.
8. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

**Beşnik DERVISHI**  
  
**KOMISIONERI**

